



# 2019-2021

## PLANI I BIZNESIT - (REVIDIM)



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A  
Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

Tel/ Fax : 029/ 244 150

E-Mail: [sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com](mailto:sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com)  
[www.hidroregjioni-jugor.com](http://www.hidroregjioni-jugor.com)

REPUBLICA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo  
 Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja  
 Ministry of Economic Development

Nr. i Njësia Org. 0113 Nr. Prot. 1860  
 Org. Jedin. Br. Prot. Prot. No.  
 Org. Unit

Nr. i llogare 01.08.19  
 Bliçitronika Data Datum  
 No. pages: PRISHTINE

**Hidroregjioni Jugor**  
 "Hidroregjioni Jugor" SH.A.  
 "Vatrat Shqiptare", p.n. 20000 Prizren  
 Tel/Fax: 029/244-150 029/244-107  
 E-mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT  
 REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOGABOEVANJE  
 »HIÐROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.

Nr. 01-52/02  
 DL 29.07.2019  
 PRIZREN

Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjiellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh. A me seli në Prizren në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike , për Plan-Biznes , në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2019 miratoi:

**REVIDIMIN E PLAN-BIZNESIT 2019-2021**

Vendimi : 01-52/02

Bordi i Drejtorëve njëzëri miratoi revidimin e Planit të biznesit për vitin 2019 në mbledhjen e XLVII të mbajtur me datë 29.07.2019.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv Besim Baraliu	Kryesuesi i BtD Rexhep Manxhuka
Nënshkrimi	<i>[Signature]</i>	<i>[Signature]</i>
Data	29.07.2019	29.07.2019

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo  
 Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja  
 Ministry of Economic Development

Nr. Prot. 1860  
 Nr. Prot. 0113

**PËRMBAJTJA**

Nr. i faqeve (brat. stranica) / No. pages: / Date Datum: 01.08.19

**HYRJE** PRISHTINË/A

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSI  
 REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOHABOVANIE

**HYDROREGJIONI JUGOR SH.A.D.D.**

Nr. 01-52/02  
 Et. 29.07. 2019

PRIZREN

<b>1</b>	<b>Përmbledhje e përgjithshme</b>	<b>5</b>
1.1	Historiku i Kompanisë	5
1.2	Deklerata e politikës	6
1.3	Deklerata e „misionit“	6
1.4	Tarifat e shërbimit	7
1.5	Qëllimet dhe objektivat strategjike	7
1.6	Objektivat kryesore të kompanisë	8
<b>2</b>	<b>Shërbimet për Konsumatorë</b>	<b>9</b>
2.1.1	Parashikimi i Kërkesës për ujë dhe rritja e konsumatorëve	9
2.1.2	Numri i Konsumatorëve- 2019-2021- KRU- HJ	10
2.1.3	Faturimi m3- 2016-2021- KRU- HJ	11
2.2	Gatishmëria për të paguar	12
2.2.1	Trendet e kërkesave më të shpeshta të konsumatorëve	12
2.2.2	Kërkesat e performancës së shërbimit ndaj konsumatorëve	12
2.2.3	Rregullimi/konvertimi i lidhjeve të paligjshme	13
2.2.4	Ndryshimet e mundshme në zonat operacionale	13
<b>3</b>	<b>Plani Operacional</b>	<b>14</b>
3.1.1	Planifikimi I zgjerimit të shërbimeve	14
3.1.2	Planifikimi I zgjerimit të shërbimeve- N.J.P - Prizren	14
3.1.3	Planifikimi I zgjerimit të shërbimeve- N.J.P - Suharekë	14
3.1.4	Planifikimi I zgjerimit të shërbimeve- N.J.P - Malishevë	14
3.1.5	Planifikimi I zgjerimit të shërbimeve- N.J.P - Dragash	15
3.2.1	Plani I investimeve kapitale	19
3.2.2	Plani I investimeve – Ujësjellës dhe kanalizim (shtesa)	20
3.3.1	Përtritja e infrastruktures	21
3.3.2	Rritja e infrastruktures	21
3.4	Objektivat kryesore të Shërbimit Teknik	23
3.5	Planifikimi i humbjeve të ujit 2019-2021	22
3.6	Plani operacional	23
3.7	Plani i menaxhimit te asetete	24
3.8	Masat e planifikuara për arrijten e objektivate	25

<b>4</b>	<b>Plani Financiar</b>	<b>25</b>
4.1	Masat e planifikuara për arritjen e objektivave	25
4.2	Planifikimi i i faturimit € - 2019-2021	26
4.3	Planifikimi i arkëtimit € - 2019-2021	27
4.4	Masat e planifikuara për arritjen e objektivave	28
4.5	Analiza e shpenzimeve	29
4.5.1	Planifikimi i shpenzimeve 2019-2021	33
4.6	Masat e planifikuara për arritjen e objektivave	33
4.7	Planifikimi i bonuseve dhe shperblimeve	33
4.8	Treguesit kryesor të performancës- 2019-2021	34
<b>5</b>	<b>Plani i zhvillimit të stafit</b>	<b>34</b>
5.1	Numri i punetoreve	35
	ORGANOGRAMI per Inpantin e UZ	36
	ORGANOGRAMI	37

## HYRJE

Plani i Biznesit për vitin 2019-2021 (I Reviduar) është një planifikim i caqeve kryesore të Kompanisë bazuar në një Modul i përgatitur paraprakisht. Planifikimi i caqeve bazohet në synimet e të gjitha Njësive punuese, në baza mujore dhe vjetore. Gjatë përgatitjes së këtij Plani të Biznesit janë angazhuar të gjitha shërbimet përkatëse të Kompanisë.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar planifikimeve mujore të të gjitha performacave e veçanërisht atyre operative dhe financiare. Forma e përgatitjes së këtij Plani të Biznesit është bazuar edhe në kërkesat për raportim nga ARRU si dhe institucionet tjera.

Qëllimi kryesorë i këtij moduli është thjeshtëzimi i mënyrës së kontrollit të performancave duke filluar nga shërbimet e caktuara, Njësitë Punuese e deri tek niveli regjional.

Ky Plan definon qartë orientimet zhvillimore të Kompanisë dhe objektivat si dhe rezultatet e pritshme duke marrë për bazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraprake.

Plani është përgatitur duke pas parasysh gjendjen ekzistuese të Kompanisë, rendet e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë si dhe jashtë Kosovës për të adoptuar praktikat më të mira të njohura për një zhvillim të qëndrueshëm të Kompanisë.

Plani i Biznesit 2019-2021 definon qartë rrugën e zhvillimit të Kompanisë duke marrë parasysh përparësitë dhe rreziqet për realizimin e suksesshëm që do të rezultojë me një arritje të vetë qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë. Parametrat financiar dhe operativ janë analizuar në mënyrë që të jenë të arritshme (duke lënë mundësinë e tejkalimit të të njëjtave) dhe të jenë sa më afër realitetit.

Plani i Biznesit është i orientuar fuqishëm edhe në drejtim të Institucioneve financiare dhe Donatorëve ku realizimi i këtij plani, e sidomos i Planit të investimeve kapitale është i varur edhe nga përkrahja që do të sigurohet nga Donatorët, Institucionet financiare si dhe institucionet qendrore dhe lokale.

## 1. PERMBLEDHJA E PERGJITHSHME

### 1.1 Historiku i Kompanise

Në vitin 1962 ka filluar të ushtrojë veprimtarinë e saj si ndërmarrje Shoqërore e njohur me emrin “Cvileni”, që nga viti 1999 ka funksionuar si Ndërmarrje Publike nën DSHP shtylla e IV e UNMIK-ut, ndërsa që nga mesi i vitit 2003 kjo Kompani është regjionalizuar me 4 njësi në vete: Prizren, Suharekë, Dragash dhe Malishevë.

Që nga Korriku i vitit 2007 funksionon si Shoqëri Aksionare K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” S.H.A.

Kompania e ujësjellësit rajonal Hidroregjioni Jugor, shërbimet e veta i ofron në pjesën jugore të Kosovës duke përfshirë këto komuna:

- **Komuna e Prizrenit** - Qyteti i Prizrenit dhe 24 Fshatra  
(Numri total i fshatrave- 72)
- **Komuna e Suharekës** – Qyteti i Suharekës dhe 12 Fshatra  
(Numri total i fshatrave – 42)
- **Komuna e Dragashit** – Qyteit i Dragashit dhe 3 Fshatra  
(Numri total i fshatrave - 38)
- **Komuna e Malishevës** – Qyteti i Malishevës dhe 17 Fshatra  
(Numri total i fshatrave - 44)
- **Komuna e Mamushës**

Rrjeti furnizues që i kryen shërbimet përfshinë 4 njësi operacionale dhe 5 Komuna: Prizren, Suharekë, Dragash , Malishevë dhe Mamushë.

Furnizimi me ujë bëhet prej burimeve vetanake. Në nivel te Kompanisë furnizohen edhe 53 fshatra që janë të kyçur ne rrjetin e Kompanisë Regjionale Prizren, Suharekë, Malishevë.

Numri i popullatës në të cilën Kompania e Ujësjellësit Regjional Prizren i kryen shërbimet e veta vlerësohet të jetë rreth 200.000 banorë.

Kapaciteti prodhues sillet deri në 900 l/sec, ketu përfshihet edhe kapaciteti permes puseve i cili eshte alternativ.

Furnizimi bëhet 45%me pompa, 55% me gravitet.

## 1.2 Deklarata e politikës

Menaxhmenti i KUR "Hidroregjioni Jugor" SH.A. i përkrahur nga palët e interesit (Bordi i Drejtorëve, aksionarët, konsumatorët etj) dhe me ndihmën e të gjithë punëmarrësve kanë për qëllim furnizimin me ujë pa ndërprerë të të gjithë konsumatorëve në zonën e shërbimit.

Të vetëdijshëm se në kushtet e tanishme kjo është një gjë e pamundur do të vihen në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe burimet financiare që të minimizohen humbjet teknike dhe zhduken në tërësi humbjet administrative të ujit nga njëra anë dhe të maksimalizohen të gjitha aktivitetet lidhur me rritjen e shkallës së arkëtimit.

Prandaj është një prioritet i përcaktuar zvogëlimi i sasisë së ujit pa të ardhura dhe pagesa për shërbimet.

Përmes këtyre aktiviteteve në të ardhmen do të krijohen kushte të favorshme për rritjen e nivelit të investimeve nga burimet vetanake.

Përmbushja e një vizioni të tillë do të krijonte parakushte më të mira për investime nga donatorët dhe agjensionet tjera financiare.

## 1.3 Deklarata e "misionit"

Misioni i KUR "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. është: furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm si dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujërave të ndotura.

Orientimi i aktiviteteve të punës do ta ketë konsumatorin në qendër të vëmendjes. Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbim: pa diskriminim racor, pa diskriminim në përkatësinë religjioze, pa diskriminim në përkatësinë kombëtare, pa diskriminim në përkatësinë gjinore.

Duke përmbushur këtë "mision" do të bëhet i mundur sigurimi i një aktiviteti të vetë financueshëm me qëllimin e fundit që të sigurojmë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Çasja e afarizmit të kompanisë do të jetë transparente dhe e bazuar në dispozitat ligjore. Kjo do të bëhet në bashkëpunim me palët e interesit:

- Punëmarrësit,
- Aksionarët-Bordin e Drejtorëve - Qeveria
- Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Ministrinë MZHE dhe Ministria e Financave,
- ARRU (Autoriteti Rregullativ i Ujërave)
- Konsumatorët ( të organizuar në komisione, shoqata etj).

#### 1.4 Tarifat e shërbimit

Kompania KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. do të zbatojë tarifën e çmimeve që do ta vendosë Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina sipas Ligjit N 03/L-086 si autoritet i vetëm dhe kompetent për përcaktimin e tarifave. Në bazë të kësaj Rregulloreje është përcaktuar "mbulimi i të gjitha kostove të operimit dhe investimeve"

Tarifat e miratuara nga ARRU do të jenë ekskluzivisht në funksion të mbulimit të shpenzimeve operative, rritjes së investimeve kapitale dhe përpjekjes për bashkëfinancimin e shumë projekteve të mundshme kapitale me komunitetin, me komunat përkatëse dhe me donatorët. Rritjet e reja do të ndikojnë pozitivisht dhe do të mobilizojnë menagjmentin dhe personelin tjetër në KUR "Hidroregjioni Jugor" SH.A. në përmbushjen me sukses të misionit të përcaktuar.

#### TARIFAT PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAT TË ZEZA 2019

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fikse (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/m <sup>3</sup> )	Tarifa volumetrike të ujërave të zeza (Euro/m <sup>3</sup> )
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.37	0.13
Konsumatori Komercial/Industrial	2.0	0.66	0.29
Konsumatori institucional	2.0	0.66	0.29

#### 1.5 Qëllimet dhe objektivat strategjike

- Zgjerimin e zonës së shërbimit me ujësjellës deri në 95%;
- Sigurimin e shfrytëzimit racional të burimeve të ujit;
- Vazhdimin e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të konsumatorëve ekzistues dhe atyre të ri në 24 orë dhe rregullimin e shtypjes së ujit në zonat që kanë problem me shtypje të ulët;
- Vazhdimin e furnizimit me ujë të cilësisë që është në pajtim me standardet e IKSHPK, d.m.th. me 100% të pajtueshmërisë së testeve të ujit;
- Mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit;

- Adoptimin e plotë të Rregulloreve të ARRU përfshirë atë të Standardeve Minimale të Shërbimeve, Licencimit, Kartën e Konsumatorëve, Politikën Tarifore të ARRU, dhe të tjera, për sigurimin cilësor të shërbimeve si dhe arritjen e të ardhurave të mjaftueshme që do të mund të mbulojnë shpenzimet operative dhe investimet e domosdomshme vjetore që do të dalin nga Planifikimi i arshshëm i Menaxhimit të Aseteve;
- Promovimin e relacioneve të mira me konsumatorë;
- Krijimin e një ambienti të favorshëm të punës për të gjithë të punësuarit dhe sigurimin fizik në punë;
- Sigurimin e stabilimenteve të një teknologjie moderne, të cilat përdoren për kryerjen e aktiviteteve të Kompanisë, të cilat i plotësojnë kërkesat për mbrojtje të shëndetit, sigurisë dhe të mjedisit;
- Regjistrimin dhe ruajtjen elektronike të të gjitha të dhënave dhe informacioneve të Kompanisë dhe organizimin e tyre në një Sistem Informativ Menaxhues funksional;
- Monitorimin e saktë të prodhimit dhe shpërndarjes së ujit, si dhe të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura përmes pajisjeve matëse të instaluar në pikat e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit duke përfshirë edhe sistemet elektronike monitoruese SCADA;
- Vazhdimin e avancimit të sistemit të të dhënave gjeografike për të përfshirë tërë zonën e shërbimit, si dhe hartimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve;
- Rritja e transparencës në raportimet të cilat i bënë Kompania ndaj menaxhimit të kompanisë, Bordit dhe palëve të treta të interesuara;
- Përfundimi i ndërtimit të impiantit të përpunimit të ujërave të ndotura;
- Mbjajtjen edhe më tutje të vetëqëndrueshmërisë financiare, përmes rritjes së normës së mbulesës së punës;
- Rritja e vlerës së asetëve për periudhën.

#### **1.6 Objektivat kryesore të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A**

- Mirëmbajtja e stabilimenteve Elektro-makinerike,
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza me qëllim të zvogëlimit të humbjeve në rrjet dhe evitimin e prishjeve me kohë,
- Aktivitetet në përfundimin e projekteve për instalimin e ujëmatësëve,

- Përpjekjet që çdo konsumatori ti matet sasia e ujit të shpenzuar dhe ti bëhet faturimi në bazë të sasisë së ujit të shpenzuar,
- Pasurimi i Sistemit Gjeografik të Informimit me të dhëna të reja,
- Përpjekjet maksimale në identifikimin e klientëve të rinj,
- Angazhimi në mbledhjen e borxheve të vjetra si dhe inkasimi i faturave rrjedhëse,
- Identifikimi dhe rritja e numrit të konsumatorëve përfshirë këtu edhe lidhjet ilegale,
- Vazhdimi i informimit të konsumatorëve dhe bashkëpunimi me organet komunale në mënyrë që shfrytëzimi i ujit të bëhet në suaza normale,
- Trajnimi i kuadrove në fusha të ndryshme si: në teknologjitë bashkëkohore të trajtimit të ujerave të pijshëm dhe ujërave të zeza, në fushën e ekonomisë, financave, etj.

## 2. SHËRBIMI PËR KONSUMATORË

Departamenti Rajonal për Shërbime të Konsumatorëve (SHK) bënë organizimin e shërbimeve dhe marrëdhëniet me konsumatorët. Siguron performancë të mirë të shërbimeve për konsumatorët, siguron komunikimin me të gjitha departamentet tjera, ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme që të grisë shkallen e arkëtimit. Urdhëron ndërprerjen e furnizimit me ujë për shkelësit e kontratës dhe monitoron ekzekutimin e urdhrat. Organizon punën e ekipeve të kontrollës dhe ç'kyçje, pranon raportet e tyre dhe ndërmerr veprime të menjëhershme dhe urgjente. Pranon kërkesat për kyçje të reja, përgatitë dokumentacionin dhe i dorëzon ato në departamentin për kompletimin e procedurave.

Shërbimi me konsumatorë është shërbim i cili organizon dhe udhëheq punën me departamentin me konsumatorë nëpër Njësit Operative, udhëheq dhe përcjell shërbimin e inkasantëve, kontrollës dhe ç'kyçje. Nëpërmes shërbimit të kontrollës identifikon konsumatorët ilegalë bën legalizimin e tyre duke i zbatuar vendimet dhe rregulloret e brendshme të kompanisë. Gjithashtu udhëheq procedurat për zgjidhjen e kontesteve me konsumatorë, merr pjesë në Këshillin Konsultativ të Konsumatorëve të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU). Pranon ankesat, kërkesave e tyre si dhe shqyrton ato në pajtim me politikën, procedurat dhe rregulloret në fuqi. Për punët dhe aktivitetet e veta ky shërbim i përgjigjet Menaxherit Financiar dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Kompania është përfundimisht e orientuar në plotësimin dhe kënaqjen e kërkesave të konsumatorëve të saj, përkundër natyrës monopolistike të biznesit të saj, si dhe sigurimin e transparencës dhe bashkëpunimit me të gjithë akterët e sektorit të ujit në Kosovë dhe më gjerë. Shërbimi i Relacionit me Konsumatorë edhe më tutje do të përmirësohet për të përfshirë regjistrimin dhe raportimin elektronikë, si dhe pranimin dhe shqyrtimin më efikas dhe brenda standardeve kohore, të ankesave të konsumatorëve.

### 2.1.1 Parashikimi i kërkesës për ujë dhe rritjes së numrit të konsumatorëve

Të tabelat vijuese mund të shihni parashikimin e kërkesës për ujë dhe rritjen e numrit të konsumatorëve të ndara në tri kategori: amvisëri, biznese dhe institucione. Tabelat në vazhdim

paraqesin rritjen e numrit të konsumatorëve dhe kërkesës për ujë në zonën aktuale të shërbimit si rezultat i lidhjeve të reja dhe konsumatorëve ilegal.

**2.1.2 Numri i konsumatorëve të planifikuar 2019 – 2021- K.R.U  
„HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A – PRIZREN**

2019-2021					
No.	Të dhënat	2018	2019	2020	2021
1	Shtëpiak	42,553	44,380	47,127	53,215
2	Ndryshimi		1,827	2,747	6,088
3	Ndryshi. %		4.3	6.2	12.9
4	Kome. -Indu.	5,733	5,828	5,904	6,104
5	Ndryshimi		95	76	200
6	Ndryshi. %		1.7	1.3	3.4
7	Institucional	305	335	360	375
8	Ndryshimi		30	25	15
9	Ndryshi. %		9.8	7.5	4.2
10	<b>TOTAL</b>	<b>48,591</b>	<b>50,543</b>	<b>53,391</b>	<b>59,694</b>
11	<b>Ndryshimi</b>		<b>1,952</b>	<b>2,848</b>	<b>6,303</b>
12	<b>Ndryshi. %</b>		<b>4.0%</b>	<b>5.6%</b>	<b>11.8%</b>

**Koment:**

**Trendi i rritjes së konsumatorëve i paraqitur në formë tabelare, është paraparë që të bëhet në :**

- **Rritja e numrit nga marrja në menaxhim i zonave rurale**
- **Rritje e numrin të konsumatorëve brenda zonës së shërbimit**
- **Legalizim i konsumatorëve ilegal**

Te tabela “NR. I Faturave” është paraqit numri i konsumatorëve sipas muajve dhe njesive që do tu ofrohen shërbimet e ujesjellsit e që do ti shtohen databazes së konsumatorëve për faturim. Në këto tabela janë paraqit të shenimet lidhur me numrin e faturave që do të leshohen në periudha përkatëse.

2.1.3 Faturimi m<sup>3</sup> - 2019 – 2021

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" S.H.A - PRIZREN

2019-2021					
No.	Të dhënat	2018	2019	2020	2021
1	Shtëpiak	6,367,385	6,802,244	7,476,699	7,816,750
2	Ndryshimi		434,859	674,455	340,051
3	Ndry. %		6.8	9.9	4.5
4	Kome.-Indu.	685,041	651,252	744,727	769,649
5	Ndryshimi		(33,789)	93,475	24,922
6	Ndry. %		(4.9)	14.4	3.3
7	Institucional	534,860	606,999	661,399	728,999
8	Ndryshimi		72,139	54,400	67,600
9	Ndry. %		13.5	9.0	10.2
10	<b>TOTAL</b>	<b>7,587,286</b>	<b>8,060,495</b>	<b>8,882,825</b>	<b>9,315,398</b>
11	Ndryshimi		473,209	822,330	432,573
12	Ndry. %		6.2%	10.2%	4.9%

*Koment: Rritja e faturimit m<sup>3</sup> për vitin dhe vitet në vijim, planifikohet të bëhet pasi regjistrimit të konsumatorëve në zonën e shërbimit.*

Faturimi m<sup>3</sup>- te kjo tabele jane paraqit kalkulimi ne m<sup>3</sup> sipas kategorive , njesive dhe muajve te viteve 2019-2021.Te dhenat e paraqitura ne kete tabele jane te kalkuluara sipas konsumit mesatar “faqja 03C-konsumi mesatar” te shumezuar me numrin e konsumatoreve te rritur sipas planifikimit. Sic shihet ne tabelat “ koeficioenti I rritjes se faturimit”, kemi shumezuar faturimin e me koeficionetin 1.04 te amviserit dhe 1.05 te bizneset dhe institucionet. Ky koeficient paraqet mundesin per rritje te faturimit si psh. Identifikim dhe shkyqjen e lidhjeve ilegale, regjistrimin e konsumatoreve ilegal, nderrimin e orematesve jofunksional, etj.

## 2.2 Gatishmëria për të paguar

Zyrtarë të këtij shërbimi planifikon përveç inkasimit derë më derë, konsumatorëve do të ju ofrohet mundësia e pagesës së faturës së shërbimeve të ujit në të gjitha bankat komerciale, në numrat e xhirollogarive që janë të shënuara në fatura. Nga ky vit është ofruar mundësia edhe pagesa në postë. Sportelet për pagesa të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit aktualisht funksionojnë nëpër objektet e kompanisë dhe objektet e Kuvendeve Komunale, planifikohet që të zgjerohet edhe nëpër në zona tjera, ku konsumatorëve do të ju ofrohet mundësi për pagesën e shërbimeve të tyre, njëkohësisht në këto sportele konsumatori do të ketë mundësi që të shpreh ankesat e tyre për shërbimet tona. Për borxhet e akumuluar të konsumatorëve do tu ofrohet ri programimi i borxhit si dhe pagesa e tij në këste mujore.

Planifikohet të organizohen edhe kampanja të vetëdijesimit të konsumatorëve lidhur me pagesën e shërbimeve të ujësjellësit, kursim të ujit apo edhe aktivitete të tjera në kuadër të shënimit të ditëve të caktuara brenda vitit.

### 2.2.1 Trendët e kërkesave më të shpeshta të konsumatorëve

Një ndër objektivat kryesore e kompanisë për vitin 2018 deri në vitin 2020 është rritja e të hyrave, respektivisht rritja e arkëtimit nëpërmjet faturimit të matur të konsumatorëve. Kompania është e orientuar që të jetë financiarisht e vetë qëndrueshme dhe e aftë ti kryej të gjitha shërbimet e domosdoshme.

Në këtë drejtim janë paraparë masa konkrete të cilat do të rezultojnë në rritjen e arkëtimit;

- Përpilimi dhe implementimi i kodit të mirësjelljes së stafit të KRU "Hidroregjioni Jugor" ndaj konsumatorëve
- Ndërrimi i terreneve të inkasantëve për evitim të familjarizimit me konsumator
- Trajnimi i stafit, me qëllim të përmirësimit të sjelljeve dhe kontakteve me konsumatorë
- Funkcionalizimi dhe profesionalizimi i Zyrës Pritëse për Konsumatorë në secilën njësi operative
- Shqyrtimi i drejtë, i paanshëm dhe në afat sa më të shpejtë i të gjitha ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve
- Leximi i rregullt dhe i saktë i ujëmatësve duke i penalizuar inkasantët për moslexim
- Faturimi sipas shpenzimit (eliminimi i faturimit paushall)
- Marrja e masave ligjore sipas ARRU-së (procedurat e shkyçjes) për konsumatorët borxhlinj
- Arkëtimi i mjeteve përmes përmbaruesve privat
- Forcimi i mëtejshëm ekipeve të kontrolles dhe ekipeve për shkyçje
- Zgjidhja e rasteve sociale në bashkëpunim me institucionet tjera relevante

Zyrtarë nga shërbimet përkatëse do të angazhohet dhe shpreson që gjatë vitit 2018-2020 të inkasojë edhe borxhet e ndërmarrjeve të privatizuar, borxhet e ri programuara pas vitit 2008 nga falja e borxheve. Njëkohësisht, do të shqyrtohen borxhet e konsumatorëve institucional që nuk po arrijnë të paguhet brenda afatit të paraparë ligjor.

### *2.2.2 Kërkesat e performancës së shërbimit ndaj konsumatorëve*

Nëpërmes funksionalizimit dhe profesionalizimit të Zyrës Pritëse për konsumator, konsumatori do ta ketë personin e parë kontaktues për ankesën dhe kërkesën që ka, gjithashtu kjo zyre do të ketë numrit te telefonit që do të jetë në dispozicion 24 orë për konsumatorin ku do ti lajmëroj të gjitha ankesat dhe kërkesat e tij .Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Konsumatorëve do të administrojë të gjitha ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve dhe në një afat sa më të shkurtër do ti shqyrtojë ato dhe do ti përgjigjet konsumatorëve.

Me qëllim të zbatimit dhe shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve do të plotësohen dhe të organizohen trajnime të stafit të shërbimit me konsumatorë.

Me përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve kompania planifikon që të arrijë edhe përmirësimin e performancave sidomos në rritjen e numrit të konsumatorëve, pasivizimin e konsumatorëve fiktiv, rritjen e sasisë së faturimit, zvogëlimin e keqpërdorimeve, zvogëlimin e lidhjeve ilegale, dhe përmirësimin e inkasimit që është një ndër objektivat kryesore dhe të domosdoshme të kompanisë.

### *2.2.3 Rregullimi/konvertimi i lidhjeve te paligjshme.*

Të gjitha lidhjet e paligjshme të cilat do të zbulohen nga ekipi i kontrollës do të legalizohen në pajtim me rregulloret e ARRU-së, duke paguar taksat dhe shpenzimet e nevojshme. ndërsa për lidhjet ilegale (by pas) para orëmatësis do të shkyçen nga rrjeti dhe rastet do të dërgohen në gjykatë.

### *2.2.4 Ndryshimet e mundshme ne zonat operacionale*

- **Ne njësinë e Prizrenit** planifikohet qe ne te ardhmen te jenë ne kuadër të shërbimeve tona këto fshatra: Hoqa e qytetit, Caparc, Kushnin me rreth 1.227 Konsumatorë
- **Ne njësinë e Suharekës** planifikohet qe të inkuadrohen rreth 13 fshatra me rreth 3.397 Konsumatorë. (Varësisht nga ecuria e projektit nga donatoret – CDI)
- **Ne njësinë e Malishevës** planifikohet qe deri ne vitin 2020, të inkuadrohen rreth 27 fshatra me rreth 3.550 Konsumatorë.. (Varësisht nga ecuria e projektit nga donatoret - CDI)
- **Ne njësinë e Dragashit** planifikohet qe të inkuadrohen rreth 10 fshatra me rreth 2.669 Konsumatorë.. (Varësisht nga ecuria e projektit nga donatoret - CDI)
- **Mamusha** ( 450 Konsumatorë)

### 3. Plani operacional

#### 3.1.1 Planifikimi i zgjerimit të shërbimit

Shërbimi me konsumatorë krahas politikës zhvillimore që e ka KRU "Hidroregjioni Jugor"sha në zgjerimin e zonës së shërbimit edhe në zonat rurale që janë jashtë menaxhimit të KRU "Hidroregjioni Jugor"sha, planifikon edhe në rritjen e stafit në këtë shërbim në të gjitha njësit operative si : futurist, inkasant dhe punëtor në kontroll/shkyçje.

Në bashkëpunim me Komunitat me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit jemi pajtuar që fshatrat të cilat janë të gatshme dhe plotësojnë kushtet teknike dhe ekonomiko financiare mund të kalojnë nën shërbimin e Kompanisë.

#### Planifikimet për zgjerimin e zonës së shërbimeve 2019-2021

Nr	Listo venbanimet	Komuna	Njësia				
				2018	2019	2020	2021
1	Prizreni	Prizren	Nr	28,682	29,522	29,850	29,850
2	Zhur	Prizren	Nr	1,089	1,104	1,110	1,110
3	Vlashnjë	Prizren	Nr	246	252	252	252
4	Kobaj	Prizren	Nr	128	129	130	130
5	Muradem	Prizren	Nr	75	77	78	78
6	Shkoz	Prizren	Nr	135	137	138	138
7	Dobrusht	Prizren	Nr	104	106	110	110
8	Vermic	Prizren	Nr	200	202	210	210
9	Grazhdanik	Prizren	Nr	68	72	74	74
10	Nashec	Prizren	Nr	300	301	305	305
11	Tupec	Prizren	Nr	65	68	70	70
12	Atmaxh	Prizren	Nr	315	318	320	320
13	Gjonaj	Prizren	Nr	510	512	514	514
14	Kojush	Prizren	Nr	72	75	75	75
15	Mazrek	Prizren	Nr	120	124	126	126
16	Planej	Prizren	Nr	95	90	85	85
17	Mile	Prizren	Nr	6	4	4	4
18	Gorozhup	Prizren	Nr	42	45	45	45
19	Serbic e Ulet	Prizren	Nr	125	127	128	128
20	Kushnin	Prizren	Nr	275	277	278	278
21	Kabashi	Prizren	Nr	107	110	112	112
22	Mamusha	Prizren	Nr		469	469	469
23	Hoqa e Qyteti	Prizren	Nr			420	420

24	Caparc	Prizren	Nr			155	155
25	Kushnin	Prizren	Nr			265	265
26	Lubizhd	Prizren	Nr				355
27	Medvec	Prizren	Nr		155	160	160
28	Novak	Prizren	Nr			50	50
29	Poslisht	Prizren	Nr				270
30	Pouskë	Prizren	Nr		133	133	133
31	Serbic e eperme	Prizren	Nr		32	32	32
32	Shpenadi	Prizren	Nr			150	150
33	Skorrobisht	Prizren	Nr			150	150
34	Smaq	Prizren	Nr		30	30	30
35	Trepetnic	Prizren	Nr		20	20	20
36	Velezh	Prizren	Nr		110	115	115
37	Zojz	Prizren	Nr		115	115	115
					<b>34,716</b>	<b>36,278</b>	<b>36,903</b>
						<b>1,562</b>	<b>625</b>
						4.5%	1.7%
1	Malishevë	Malishevë	Nr	1,545	1405	1510	1645
2	Banjë	Malishevë	Nr	540	586	622	640
3	Kravasari	Malishevë	Nr	124	133	141	145
4	Burim	Malishevë	Nr	133	143	151	156
5	Gurbardh	Malishevë	Nr	217	234	248	256
6	Lumishtë	Malishevë	Nr	152	177	187	193
7	Mirushë	Malishevë	Nr	104	112	119	123
8	Turjak	Malishevë	Nr	274	299	317	326
9	Bubël	Malishevë	Nr	75	80	84	87
10	Damanek	Malishevë	Nr	212	228	241	249
11	Maxharë	Malishevë	Nr	75	80	84	87
12	Qypevë	Malishevë	Nr	28	28	30	31
13	Dragobil	Malishevë	Nr	125	130	137	142
14	Bellanicë	Malishevë	Nr	357	367	389	401
15	Lladroc	Malishevë	Nr	240	261	276	284
16	Carrallukë	Malishevë	Nr	248	270	287	295
17	Drenoc	Malishevë	Nr	550	605	641	660
18	Panorc	Malishevë	Nr		130	135	140
19	Rud	Malishevë	Nr		50	52	55
20	Astrazup	Malishevë	Nr		120	150	180
21	Terpezë	Malishevë	Nr		130	135	140
22	Shkozë	Malishevë	Nr		78	80	85
23	Bardh	Malishevë	Nr		137	139	140

24	Ngucat	Malishevë	Nr		150	185	200
25	Senik	Malishevë	Nr		50	100	175
26	Terpezë e ult	Malishevë	Nr		35	70	75
27	Shkarashnik	Malishevë	Nr		80	130	140
28	Bubavec	Malishevë	Nr			100	200
29	Kijevë	Malishevë	Nr			70	100
30	Mleqan	Malishevë	Nr			100	130
31	Vermicë	Malishevë	Nr			85	120
32	Llazicë	Malishevë	Nr			85	150
33	Balincë	Malishevë	Nr			90	130
34	Plloqicë	Malishevë	Nr			90	125
35	Pagarushë	Malishevë	Nr			100	200
36	Marali	Malishevë	Nr				100
37	Guriq	Malishevë	Nr				70
38	Gajrak	Malishevë	Nr				30
39	Llapqev	Malishevë	Nr				110
40	Temeqin	Malishevë	Nr				100
					<b>6,098</b>	<b>7,360</b>	<b>8,615</b>
						<b>1,262</b>	<b>1,255</b>
						20.7%	17.1%
1	Suharekë	Suharekë	Nr	2,040	2,500	2,625	2,783
2	Mushtisht	Suharekë	Nr	569	708	722	737
3	Sallagrazhde	Suharekë	Nr	208	216	220	225
4	Gjinoc	Suharekë	Nr	161	138	141	144
5	Savrovë	Suharekë	Nr	123	123	125	128
6	Sopijë	Suharekë	Nr	358	372	379	387
7	Shirokë	Suharekë	Nr	362	409	417	426
8	Reshtan	Suharekë	Nr	304	307	313	319
9	Studenqan	Suharekë	Nr	367	480	490	499
10	Magjistrale	Suharekë	Nr	147	145	148	151
11	Semetisht	Suharekë	Nr	224	225	230	234
12	Samadraxhë	Suharekë	Nr	405	451	460	469
13	Dobërdelan	Suharekë	Nr	221	250	255	260
14	Gelancë	Suharekë	Nr	280	284	290	295
15	Leshan	Suharekë	Nr	367	365	372	380
16	Tërrnje	Suharekë	Nr	174	175	179	182
17	Bukosh	Suharekë	Nr		230	235	239
18	Dubravë	Suharekë	Nr			214	218
19	Greikoc	Suharekë	Nr		645	658	671
20	Baqevc	Suharekë	Nr			56	57
21	Peqan	Suharekë	Nr			415	423

22	Bllacë	Suharekë	Nr			658	671
23	Nepërbisht	Suharekë	Nr			153	156
24	Sllapuzhan	Suharekë	Nr				218
25	Maqitevë	Suharekë	Nr				94
26	Reqan	Suharekë	Nr				229
27	Budakov	Suharekë	Nr				640
28	Muhlan	Suharekë	Nr				104
29	Dvoran	Suharekë	Nr				52
30	Vraniq	Suharekë	Nr				437
					8,023	9,755	11,829
						1,732	2,074
						21.6%	21.3%
1	Dragash	DRAGASH	Nr		965	970	975
2	Pllavë	DRAGASH	Nr		232	228	230
3	Brezne	DRAGASH	Nr		260	255	257
4	Shajne	DRAGASH	Nr		29	30	31
5	Zgatar	DRAGASH	Nr			236	236
6	Brrut	DRAGASH	Nr				250
7	Kapre	DRAGASH	Nr				70
8	Bellobrad	DRAGASH	Nr				200
9	Rapqë e Eperëm	DRAGASH	Nr				150
10	Rapqë e Ulët	DRAGASH	Nr				100
11	Vraniq	DRAGASH	Nr				170
					1,486	1,719	2,669
						233	950
						15.7%	55.3%
	<b>TOTAL</b>			<b>48,591</b>	<b>50,543</b>	<b>55,112</b>	<b>60,016</b>
	Ndryshimi				1,952	4,569	4,904
	Ndryshimi ne %				4.0%	9.0%	8.9%

Arritur      Caqet      Caqet      Caqet

Zona e shërbimit- ne tabelar jane paraqit emrat e vendbanimeve dhe numri I konsumatoreve sipas njesive operative. Lista e fshatrave te paraqitura ne tabelar eshte zotim I personave pergjegjes qe do me merren ne menaxhim sipas viteve perkatese.

## PRODHIMI 2019-2021

2019-2021					
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN					
No.	Të dhënat	2018	2019	2020	2021
		m3	m3	m3	m3
	NJËSIA P.				
1	PRIZREN	12,803,162	12,630,378	12,969,988	14,648,638
2	SUHAREKË	1,917,178	2,526,731	2,466,015	2,515,499
3	MALISHEVË	1,419,524	1,210,878	1,310,878	1,514,721
4	DRAGASH	899,170	1,010,878	1,030,609	1,051,316
5	MAMUSHË		-	388,441	408,776
6	TOTAL	17,039,034	17,378,865	18,165,931	20,138,950
	NDRYSHIMI		339,831	787,066	1,973,019
	NDRYSHIMI %		2.0%	4.5%	10.9%

Rritja e Prodhimit të ujit është planifikuar varësisht nga rritja e numrit të konsumatoreve përmes:

- Projekteve të cilat janë duke u implementuar nga investimet e bëra të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë Zvicerane për Zonat Rurale, në gjithë zonën e shërbimit të KRU"HRJ"sh.a,
- Investimet e planifikuara për furnizim me ujë të pijes për Rajonin e Anadrinisë dhe Hasit Projekte për furnizim me ujë të Anadrinisë dhe Hasit janë planifikuar të realizohen gjatë periudhës kohore 2019-2021, në i kemi dorëzuar në MZHE, presim investimet e mundshme nga MZHE ose ndonjë donator të jashtëm.

Furnizimi me ujë të pijshëm për konsumatorët ekzistues dhe ata të rinj planifikohet të zgjatet në 24 orë të kontinuitetit të furnizimit. Planifikohet që edhe gjatë sezonit të verës të përmirësohet furnizimi me ujë të pijshëm edhe në zonat e presionit të lartë.

Poashtu gjatë viteve 2019-2021 Kompania planifikon të përmirësojë cilësinë e ujit të pijshëm deri në 100% të përmbushjes së standardeve të përcaktuara nga Instituti Kombëtarë i Shëndetësisë Publike në Kosovë.

### *3.2.1 Plani i investimeve kapitale*

Plani i Investimeve është një pjese e rëndësishme e Planit të Biznesit, i cili i mundëson ujësjellësit të përmirësojë shërbimet ndaj konsumatore. Përmirësimi i shërbimeve do të ndikojë edhe në përmirësimin e moralit të pagesave tek konsumatorët..

Plani i investimeve do të përbëhet prej një përzierje të projekteve, ku disa prej tyre do të jene pjese e financimit nga Kompania nga të ardhurat e tyre. Megjithatë ekziston një numër i projekteve të mëdha të cilat kërkojnë financim të jashtëm edhe vlerësim të detajuar.

Qëllimi i Planit të Investimeve është që të siguroje se Kompania është duke bere planifikim të përshtatshëm për mirëmbajtjen e rregullt dhe zhvillimin e infrastrukture se ujësjellësit.

Identifikimi i investimeve, me qëllim të arritjes së ndryshimeve të standardeve të kualitetit apo shërbimeve shqyrtohet sipas vlerësimit të gjendjes së aseteve që janë në dispozicion me qëllim të arritjes së gadishmerisë teknike të pajimeve. Këto investime planifikohen të jenë pjesë e graveve nga KfW, MZHE, MEF, Kuvendi Komunal si dhe nga mjetet vetanake të Kompanisë.

Në bazë të analizës dhe gjendjes momentale që kemi në terren, në kemi përcaktuar prioritetet e investimeve në nivel të Kompanisë-Njesive punuese.

Këto prioritetet janë të domosdoshme ngase:

- përmirësohet dukshëm furnizimi me ujë
- përmirësohet cilësia e ujit dhe shtypja konform standardeve në fuqi
- zvogëlohen humbjet teknike dhe komerciale
- shtohet numri i konsumatoreve të rinj
- zvogëlohen shpenzimet operative të mirëmbajtjes
- rritet shtimi i shërbimeve të Kompanisë
- evitohet mundësia e ndotjes së ujit të pijes nga ujërat e zeza

Planifikimi i investimeve për vitin 2019-2020-2021 është bazuar, në mundësinë e donacioneve si dhe programeve impementuese të Donatorëve si;

**KfW-** Projekt i grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe Eficienca e energjisë elektrike,

**CDI-** Programi për Rehabilitimin e zonave rurale

**MZHE-** Projektet e parapara sipas Programit PIP

**Mjete Vetanake (nga Kompania)-** Kemi përzgjedhur investimet prioritare në rehabilitim të rrjetit të ujësjellësit etj, duke u bazuar në mbëlueshmerinë operative.

Investimet ne ujera te zeza kryesisht janë prante te pastra, përpos disa investimeve ne rehabilitimin e rrjetit ekzistues ne Suhareke dhe Prizren si dhe ne aktivite biznesore qe parashih kompania ti beje me mjete vetanake  
Sa I përket regjistrimit si asete, këto projekte janë ne vijim dhe ne momentin qe do te finalizohen do te regjistrohen si asete,  
Sipas planeve dinamike te nënshkruara ne kontratat për te dy fazat, punimet pritet te përfundojnë ne tremujorin e pare te vitit 2019, plus një vit komisionim.

### *3.2.2 Plani i investimeve- ujësjellës dhe kanalizim*

*(shiko shitesën: Investimet e planifikura 2019-2021)*

*Automjetet e ekipeve te inspektoratit dhe lexuesit e konsumatoreve te medhenj jane amortizuar dhe eshte me se e nevojshme qe te zevendesohen me automjete te reja.*

Në të njëjtën kohë Kompania zotohet në shfrytëzimin racional të burimeve të ujit dhe në mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

### *3.5 Planifikimi i humbjeve të ujit 2019-2021*

Shërbimi Teknik në bashkëpunim me të gjitha shërbimet e tjera të kompanisë parashikon që deri në fund të vitit 2019 të zvogëlojë humbjet e ujit deri në 54 %. Kjo duke marrë parasysh se zonat e reja që priten të merren në menaxhim në fillim do të kenë humbje të mëdha të ujit.

Këto synime mendojmë se janë reale dhe bazohen në këto faktorë;

- Zvogëlimi i humbjeve teknike
  - Zëvendësimi i rrjetit të vjetruar
  - Detektimi i rrjedhjeve të ujit
  - Evidentimi dhe sanimi i rrjedhjeve nëntokësore dhe mbitokësore
  - Etj.
  
- Zvogëlimi i humbjeve komerciale
  - Evidentimi dhe eliminimi i lidhjeve të paligjshme
  - Instalimi apo zëvendësimi i ujëmatësëve
  - Faturimi sipas konsumit real (eliminimi i faturimit paushall)

### **3.6 Plani operacional**

Programet operacionale teknike në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, stabilimentet Elektro Mekanike, infrastrukture dhe jo infrastrukture në vitin 2019-2021 do të kemi;

Investimet në infrastrukturën e ujërave të zeza janë me të mëdha karshi investimeve të bëra në rrjetin e ujësjellësit. Planifikimi I investimeve në përpunimin e ujërave të zeza është projekt duke u bazuar në fizibilitetin e ujërave të zeza për qytetin e Prizrenit të bërë nga KfW.

### 3.7 *Plani i menaxhimit te aseteve*

Duke pasur parasysh gjendjen e tanishme të aseteve, mendojmë se nuk ka qenë një planifikim i mirëfilltë në menaxhimin e aseteve dhe gjendja e aseteve është në një gjendje jo të kënaqshme. Asetet që tani kemi në shfrytëzim janë sipas periudhave të ndërtimit para lufte dhe pas lufte .

Duke parë gjendjen e aseteve pas lufte janë bërë investime në Rehabilitimin dhe ndërtimin e Rezervarëve të rinj rrjetet e ujësjellësve dhe kanalizimeve , fazineri, ujëmatës të profileve të ndryshme si dhe në mjetet e punës, ndihma me makineri në shtimin e sasisë së ujit ,në kualitetin e ujit.

Të gjitha këto ndihma ,investime kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes së aseteve dhe performansës se Kompanive .

Tani kemi një gjendje më të mirë, por ka ende për të bërë .

Duke pasur parasysh gjendjen e aseteve dhe analizave të bëra nga të dhënat e përditshme kemi përcaktuar objektivat dhe prioritetet e projekteve.

Objektivat tona për të pasur një menaxhim më të mirë dhe kontrollë mbi asete janë;

- Zëvendësimi i rrjetave të vjetërsuara të ujit dhe kanalizimit
  - Mirëmbajtja e rrjetit të ujit dhe kanalizimit,
  - Zgjerimi i grupit i për detektimin e humbjeve,
  - Zbatueshmeri e procedurave të punës, në përpikëri nga përgjegjësit e thirrur,
  - Plotësimi i rregullatives së brendshme –adresimi më i mirë dhe më i saktë i përgjegjësive
  - Planifikimi i resurseve njerëzore –trajnimet e nevojshme
  - Shfrytëzimi i të gjitha veglave menaxhuese .
  - Realizimi i projekteve sipas dinamikës së dhënë .
  - Furnizimi me pajisje më të justifikueshme për detektimin e humbjeve dhe matjen sakte te prodhimit të ujit.
- Incizimin Gjeodezik, Digjitalizimi i rrjetit te kanalizimit dhe rrjetit te ujesjellsesit, Modelimi Hidraolik, perditësimi i te dhënave ne sistemin Auto Cad dhe sistemi i tyre ne GIS, Kriteria keto te kërkuara nga Donatoret si KfW, Qeveria e Kosoves etj po ashtu dhe nga ARRU-ja.

#### *Masat e planifikuara për arritjen e objektivave*

Në këtë drejtim janë paraparë masa konkrete të cilat do të rezultojnë në arritjen e objektivave te planifikuara ne departamentin Teknik si:

- Prodhimit i ujit

- Prodhimit i ujit është planifikuar ne baze te rritjes se numrit te konsumatoreve si dhe zgjerimit te zonës se shërbimit, implementimi i Projekteve te cilat janë duke u zbatuar nga investimet e bëra te Qeverise se Kosovës dhe Qeverise Zvicerane për Zonat Rurale, e qe konsistojnë ne zgjerimin e zonës se shërbimit te KRU"HRJ"sh.a
- Zvogëlimi i humbjeve teknike
- Zëvendësimi i rrjetit të vjetruar, duke zbatuar projektet te planifikuara ne planin e biznesit 2019-2021 qe konsistojnë ne zvogëlimin e humbjeve teknike.
- Detektimi i rrjedhjeve të ujit, zgjerimi i grupit te dedektimit dhe ngritja e kapacitetve profesionale duke marr pijes ne trajnimet qe organizohen ne nivel vendi.
- Evidentimi dhe sanimi i rrjedhjeve nëntokësore dhe mbitokësore, paisja me mjete pune per ekipet operative dhe krijimi i kushteve per pun efikase.
- Realizimi i projekteve sipas dinamikës së dhënë.
- Implementimi i projektit (SCADA) ku përfshihen ndërrimi i ujëmatësve te prodhimit dhe vendosja e ujëmatësve digjital dhe inkorporimi ne (SCADA)-sistem.
- Identifikimi dhe digjitalizimi i sistemi te ujësjellësit ne nivel regional.

#### *4 Plani financiar*

Një ndër objektivat kryesore e kompanisë për vitet 2018-2020 është rritja e të hyrave, respektivisht rritja e arkëtimit dhe zvogëlimi i shpenzimeve (aty ku është e mundur). Kompania është e orientuar që të jetë financiarisht e vetëqëndrueshme dhe e aftë ti kryej të gjitha shërbimet e domosdoshme.

##### *4.1 Masat e planifikuara për arritjen e objektivave*

Në këtë drejtim janë paraparë masa konkrete të cilat do të rezultojnë në rritjen e inkasimit;

- Përmirësimi i shërbimeve ndaj konsumatorëve
- Trajnimi i stafit , me qëllim të përmirësimit të sjelljeve dhe kontakteve me konsumatorë
- Informimi i drejtë dhe me kohë i konsumatorëve
- Shqyrtimi i drejtë dhe në afat sa më të shpejtë i të gjitha ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve
- Leximi i rregullt dhe i saktë i ujëmatësve
- Faturimi sipas shpenzimit (Eliminimi i faturimit paushall)
- Kontaktet me konsumatorë me shumë të lartë të borxheve ndaj kompanisë (mundësia e nënshkrimit të kontratave për shlyerjen e borxheve me këste)
- Marrja e masave ligjore sipas Zyrës Rregullative (procedurat e shkyçjes)
- Forcimi i ekipeve të kontrolles dhe ekipeve për shkyçje

- Zgjidhja e rasteve sociale në bashkëpunim me institucionet tjera relevante
- Faturat do t'i lëshohen të gjithë konsumatorëve të regjistruar, çdo muaj, duke u bazuar kryesisht në konsumin e lexuar. Gjatë periudhës 2019-2024 pritet të ngritet norma e faturimit e bazuar në lexim të ujëmatësve deri në 100%. Këtu do të përfshihet edhe pastrimi i bazës së të dhënave për të larguar konsumatorët jo-ekzistent dhe për të aktivizuar ata pasiv.

#### 4.2 Planifikimi i Faturimit € 2019-2021

2019-2021					
No.	Të dhënat	2018	2019	2020	2021
1	<b>Faturimi-€</b>	4,294,313.83	5,285,942.84	5,484,062.26	5,758,249.94
2	Total- Shte.	3,157,088.20	3,898,179.34	4,076,479.21	4,265,886.50
3	Ndryshimi		741,091.14	178,299.87	189,407.29
4	Ndry. %		23.5%	4.6%	4.6%
5	Total- kome.	680,617.58	800,160.29	809,411.34	829,947.35
6	Ndryshimi		119,542.71	9,251.06	20,536.01
7	Ndry. %		17.6%	1.2%	2.5%
8	Total-Inst.	456,608.05	587,603.21	598,171.71	662,416.08
9	Ndryshimi		130,995.16	10,568.50	64,244.37
10	Ndry. %		28.7%	1.8%	10.7%
11	Te tjera	72,553.33	14,800.00	22,030.00	24,925.00
12	<b>Total</b>	<b>4,366,867.16</b>	<b>5,300,742.84</b>	<b>5,506,092.26</b>	<b>5,783,174.94</b>
13	Ndryshimi		933,875.68	205,349.42	277,082.68
14	Ndry. %		21.4%	3.9%	5.0%

- Faturimi ne euro. Paraqet sasin e planifikuar ne m<sup>3</sup> sipas kategorive, muajve , njesive operative te shumezuar me tarifen e percaktuar me urdheres tarifore nga ARRU.

### 4.3 Planifikimi i Arkëtimit € 2019-2021

#### K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A – PRIZREN

2019-2021					
No.	Të dhënat	2018	2019	2020	2021
1	Total- Shtëpiak	3,023,195.06	3,313,452.44	3,465,007.33	3,626,003.53
2	Ndryshimi		290,257.38	151,554.89	160,996.20
3	Ndry. %		9.6%	4.6%	4.6%
4	Total-Komercial-Industrial	608,898.20	800,160.29	809,411.34	829,947.35
5	Ndryshimi		191,262.09	9,251.06	20,536.01
6	Ndry. %		31.4%	1.2%	2.5%
7	Total Institucional	477,552.18	587,603.21	598,171.71	662,416.08
8	Ndryshimi		110,051.03	10,568.50	64,244.37
9	Ndry. %		23.0%	1.8%	10.7%
10	Total - ujë	4,109,645.44	4,701,215.94	4,872,590.38	5,118,366.96
11	Ndryshimi		591,570.50	171,374.44	245,776.58
12	Ndry. %		14.4%	3.6%	5.0%
13	Te tjera	41,637.09	12,253.00	22,030.00	24,925.00
14	Ndryshimi		(29,384.09)	9,777.00	2,895.00
15	Ndry. %		-70.6%	79.8%	13.1%
16	TOTAL	4,151,282.53	4,713,468.94	4,894,620.38	5,143,291.96
17	Ndryshimi		562,186.41	181,151.44	248,671.58
18	Ndry. %		13.5%	3.8%	5.1%

#### *4.4 Masat e planifikuara për arritjen e objektivave të Kompanisë*

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes financiare të Kompanisë janë planifikuar masa konkrete në përmirësimin e gjendjes aktuale:

- Përmirësimi i leximit të saktë të konsumit të ujit të pijes,
- Marrja e masave ndëshkuese ndaj mos leximit apo leximit qëllimisht të gabuar.
- Zvogëlimi i faturimit paushall.
- Vendosja e ujëmatësve tek konsumatorët pa ujëmatës apo ndërrimi i ujëmatësve jo funksional.
- Zvogëlimi i keqpërdorimeve
- Forcimi i ekipës së kontrollës
- Marrja e masave ligjore ndaj kyçjeve të paligjshme.
- Përmirësimi i inkasimit.
- Përmirësimi i raporteve Konsumatorë-Kompani
- Përgatitja dhe realizimi i fushatave të vetëdijesimit të popullatës duke bashkëpunuar edhe me institucionet tjera (Kuvendin Komunal, SHPK-ne, Gjykatat dhe Mediat).

Një ndër objektivat kryesore e kompanisë për vitet 2016 - 2021 është rritja e të hyrave, respektivisht rritja e arketimit. Kompania është e orientuar që të jetë financiarisht e vetë qëndrueshme dhe e aftë ti kryej të gjitha shërbimet e domosdoshme.

#### *4.5 Analiza e shpenzimeve*

Sa i përket analizës së shpenzimeve Kompania “Hidroregjioni Jugor” SH.A do të financojë në mënyrë kualitative shpenzimet operative, të mirëmbajtjes.

Te gjitha shpenzimet, edhe ato që i përkasin stafit do të orientohen në funksionimin normal të të gjitha segmenteve të punës në ujësjellës dhe prioritet kryesor është arritja e objektivave që janë përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij Plani të Biznesit.

Kursimi ose ulja e kostos së energjisë elektrike gjatë vitit 2019-2021 planifikohet të arrihet me realizimin e investimeve nga Donatori i Bankes Gjermane KfW. Dhe CDI-së.

Një aktivitet tjetër në këtë drejtim është se Kompania do të përqendrohet në kursimin e energjisë elektrike në disa stacione të pompimit, ku gjatë orëve të mbrëmjes do të ç’kyçen prej punës 40% të pompave.

Kompania do të angazohet që të zvogëlojë edhe shpenzime tjera, aty ku është e mundur në mënyrë që me të hyrat e arkëtuara t'i mbulojë shpenzimet e rregullta operative; shpenzimet e kompensimit për punën jashtë orarit, shpenzimet për palët e treta etj

#### 4.5.1. Planifikimi i shpenzimeve – 2019- 2021

##### ***SHPENZIMET - 2019-2021 (REVIDIM)***

**K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN**

<b>NDRYSHIMI I SHPENZIMEVE - 2018-2021</b>					
<b>No.</b>	<b>Të dhënat</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>
<b>1</b>	<b>Total Shpenzimet Operative në €</b>	<b>3,638,837.12</b>	<b>4,132,447.13</b>	<b>4,720,007.38</b>	<b>4,729,888.24</b>
	<b>Ndryshimi në %</b>		<b>13.6%</b>	<b>14.2%</b>	<b>0.2%</b>
2	Pagat	2,070,016.29	2,330,000.00	2,461,277.70	2,535,116.03
	<b>Ndryshimi në %</b>		<b>12.6%</b>	<b>5.6%</b>	<b>3.0%</b>
3	Rryma elektrike	851,608.07	980,500.00	1,020,215.00	1,050,821.45
	<b>Ndryshimi në %</b>		<b>15.1%</b>	<b>4.1%</b>	<b>3.0%</b>
4	Shpen. e derivateve	85,875.30	80,918.66	85,918.66	90,918.66
	<b>Ndryshimi në %</b>		<b>-5.8%</b>	<b>6.2%</b>	<b>5.8%</b>
5	Mirem. dhe riparimet	262,875.84	334,942.54	355,290.82	365,949.54
	<b>Ndryshimi në %</b>		<b>27.4%</b>	<b>6.1%</b>	<b>3.0%</b>
6	Mirem. e automjeteve	49,898.29	44,492.84	45,827.63	47,202.45
	<b>Ndryshimi në %</b>		<b>-10.8%</b>	<b>3.0%</b>	<b>3.0%</b>
7	Shpen.e taksave	87,979.25	88,018.04	90,658.58	93,378.34
	<b>Ndryshimi në %</b>		<b>0.0%</b>	<b>3.0%</b>	<b>3.0%</b>
8	Kemikaliet	12,997.04	26,486.21	27,280.80	28,099.22
	<b>Ndryshimi në %</b>		<b>103.8%</b>	<b>3.0%</b>	<b>3.0%</b>
9	Shpenzimet e tjera	217,587.04	247,088.84	254,501.51	262,136.55
	<b>Ndryshimi në %</b>		<b>13.6%</b>	<b>3.0%</b>	<b>3.0%</b>

## Planifikimi i parallogaritjeve për kostot operative të Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza

Të përgjithshme:

KRUHRJ po ndërton për momentin një ITUZ. Nga orari më i fundit i implementimit, impianti do të fillon operimin para shtatorit të vitit 2019.

Në mënyrë që të ofrohet një buxhet i arsyeshëm për operimin dhe mirëmbajtjen e ITUZ, parallogaritjet janë grumbulluar nga kompanitë e kontraktuara ndërtimore dhe studimet e mëparshme, nga skema e pagave e HRJ-së, kontratat ekzistuese për energji elektrike dhe shërbimet tjera.

Vëllimet e ujërave të zeza të trajtuara

ITUZ është dizajnuar për trajtimin e 50.000 banorëve, që në vëllime është përafërsisht rreth 4.7 Mio m<sup>3</sup> në vit.

Vëllimet e ujërave të zeza që arrijnë tek ITUZ përmbajnë ujërat e zeza nga amvisëritë, bizneset dhe institucionet, përfshin edhe ujërat e shiut për shkak të sistemit pjesërisht të kombinuar të kanalizimit me ujërat nga reshjet si dhe për shkak të infiltrimeve. Infiltrimet në rrjedhën në kohën me thatësi parashihet të jenë 100%-110%.

Siq ka qenë vëllimi momental i ujërave të zeza në njësinë e Prizrenit në vitin 2017 duke paraqitur rreth 5,0 Mio m<sup>3</sup>, ndërsa parashihet që ITUZ do të operon me kapacitet të plotë që nga fillimi i operimit.

Kjo jep kosto operative pothuajse të njejta për secilin muaj të operimit.

Planifikimi i kostove – Të përgjithshme

Planifikimi i kostove për ITUZ-në është strukturuar sipas metodologjisë së tarifave nga ARRU për Seksionet 22.1.2 Trajtimi i ujërave të zeza dhe 22.1.3 Trajtimi i llumit dhe largimi.

Secili pozicion i kostove është planifikuar në baza mujore duke konsideruar

Periudhën para-operimit në vitin 2018 (tashmë subjekt i aplikimit tarifor fillestar 2018-2020),

Viti 2019 që përfshin fillimin e operimit të ITUZ-së dhe kostot e rregullta operative të reduktuara për shkak të vetëm 10 muajve të parapara për operim dhe një strukturë pakëz më ndryshe të kostove për shkak të garancive kundrejt kontraktorit, dhe

Viti 2020 që paraqet vitin e parë me 12 muaj operim dhe seriozitet të plotë nga HRJ.

Parallogaritjet e detajuara mbrapa pozitave të kostove janë përshkruar në vijim. Të gjitha detajet e llogaritjeve janë bashkangjitur për t'i kuptuar më mirë shpjegimet në vijim:

Kostot e kemikaleve

Procesi i trajtimit të ujërave të zeza kërkon kemikale, prej të cilave më të rëndësishmet janë Polielektrolitet Kationike. Vëllimet e nevojshme dhe çmimet për njësi janë marrë nga Kontraktori. Kostot për kemikale janë paraparë rreth 18,000 Eur në vit., ndërsa rreth 15,000 nevojiten për stabilizimin e llumit të kanalizimit.

### Kostot e Energjisë Elektrike

Proceset e trajtimit të ujërave të zeza kërkojnë energji intenzivisht. Dizajni i Kontraktorit përshkruan konsumet e pritshme të energjisë për të gjithë objektin si dhe konsumin për secilën fazë gjatë procesit të pastrimit në detaje.

Konsumi i paraparë i energjisë elektrike i Impiantit është 1,77 Mio kWh në vit., që paraqet rreth 121,000 Eur në vit. duke aplikuar kostot momentale të energjisë elektrike prej 0,0684 Eur/kWh

Pothuajse 2/3 e konsumit të energjisë elektrike nevojitet për linjën e llumit, ndërsa linja e ujit ka nevojë për energjinë që mbetet.

### Kostot e Derivateve dhe kostot tjera për makinat

Kostot e pritshme në terren dhe për transportimin e personelit janë paraparë rreth 3,000 Eur në vit.

### Kostot e stafit

Pozicioni më i madh i kostove tek impianti për trajtimin e ujërave të zeza nevojitet për stafin si dhe për operimin dhe mirëmbajtjen e objektit.

Kontraktori ka nxjerrë një listë të stafit të operimit duke përfshirë aftësitë e nevojshme sipas dizajnit aktual dhe regjimi i pritshëm i operimit.

Për shkak të shkurtimeve të kostove gjatë dizajnit, sistemi i monitorimit (Scada sistemi) është momentalisht në fazat fillestare, që do të kërkon intervenime të dukshme operuese dhe punë monitoruese që duhet të kryhen nga stafi i HRJ-së. Kontraktori ka rekomanduar që në objekt të kemi ekipin e kompletuar të operatorëve 24/7, që do të na dërgonte tek një numër i stafit që nuk do të pranohej të financohet. Është dakorduar me kontraktorin të vendoset regjimi i operimit dhe koncepti i mirëmbajtjes në një mënyrë që të gjitha punët e mirëmbajtjes të mund të bëhen gjatë orarit të rregullt të punës dhe që për kohën e mbetur dhe gjatë vikendeve vetëm një ekip monitorues të nevojitet të jetë prezent.

Kërkesat në vijim për stafin mund të përmbliidhen sikurse në vijim:

Pozitat	Nr i stafit gjatë orarit të rregullt të punës	Nr i stafit në ndërrime, vikende	Totali
Menaxheri i Impiantit	1	të jetë në dizpozicion të ndan përgjegjësinë me menaxherin e o&m	1
Menaxher i Operimit & Mirëmbajtjes	1	të jetë në dizpozicion të ndan përgjegjësinë me menaxherin e impiantit	1
Administrative	1		1
Teknik laborator	1		1
Asistent laborator	1		1
Teknik Elektro- mekanik	2	1 (*4 për të mbuluar ndërrimet)	6
Punëtor fizik	5	2 (*4 për të mbuluar ndërrimet)	13
Sigurim, Roje	1	1 (*4 për të mbuluar ndërrimet)	5
Totali	13	16	29

Pagat janë llogaritur sipas koeficientit që aplikohet për secilën pozitë. Për të gjitha kostot e stafit (taksat, sigurimet, ndihmat), mesatarja e kompanisë prej 39% është aplikuar sipër pagave.

Kostot totale të stafit për operimin dhe mirëmbajtjen e ITUZ janë (në një vit të plotë të operimit) 181,000 Eur.

Është e rëndësishme të ceket se pozitat e cekura dhe numri i stafit kërkohen si 'Qendër e Kostove'-ITUZ. HRJ po përpiqet të rekruton sa më shumë persona me aftësi në mënyrë interne dhe vetëm pjesa tjetër e stafit do të përzgjedhet jashtë kompanisë. Numri i reduktuar i stafit në këtë buxhet paraqitet tek departamentet/qendrat e kostove.

Kostot e materialit dhe të konsumueshmeve, Kostot për shërbimet e kontraktuara

Një shumë mesatare adekuate për pjesët rezervë dhe të konsumueshmet tjera është projektuar me 1% në vit të koston së investimit (vetëm investimet elektromekanike). Materialet dhe të konsumueshmet për punët civile nuk janë konsideruar.

Buxheti përkatës për materialin dhe të konsumueshmet rezulton me 41,000 Eur në vit., ku gjysma llogaritet për trajtimin e ujërave të zeza dhe gjysma për trajtimin e llumit.

Kostot për shërbimet e kontraktuara gjatë viteve të para aplikohen kryesisht për inspektimet obligative (p.sh. të stacionit transformues dhe zjarrfikëseve), ndërsa shërbimet e mirëmbajtjes nga pala e tretë do të mbulohen deri në vitin 2020 kryesisht me garanci.

Rreth 11,000 Eur në vit duhet të mjaftojnë për shërbimet e kontraktuara.

#### Mirëmbajtje dhe riparimi

Mirëmbajtja e rregullt dhe riparimi janë esenciale për operimin e suksesshëm afatgjatë të impiantit. Mungesa e mirëmbajtjes adekuate na dërgon drejt ngritjes së shpejtë të kostove të riparimit. Financimi i kostove të mirëmbajtjes llogaritet me 3% në vit të shumës së investimit për pajisjet elektrike dhe mekanike dhe me 1% për punët ndërtimore.

Një pjesë domethënëse e këtyre kostove do të mbulohet nga Kontraktori në vitin 2019 (50% e kostove të rregullta janë aplikuar), ndërsa prej 2020 e tutje HRJ-së do t'i nevojiten rreth 170,000 Eur në vit që të siguron mirëmbajtjen e investimit.

#### Kostot për hedhjen(largimin) e llumit

Dizajni aktual ofron dy opsione kryesore për trajtimin dhe largimin e llumit.

Llumi i trashur pompohet për tek 24 shtretërit me kallam gjatë një procesi 6-8(10) vjeçar. Pas kësaj periudhe, transformohet në humus dhe duhet të largohet nga shtretërit me kallam dhe mund të përdoret ose hedhet jashtë objektit. Kualiteti i llumit është shumë i mirë. Momentalisht planifikohet të pompohet llumit për tek shtretërit me kallam gjatë muajve të verës /me thatësi (8 muaj). Kostot gjatë periudhës rregullatore janë reduktuar dukshëm pasi që vetëm kostot e pompimit ndodhin.

Llumi i trashur dehidratohet mekanikisht dhe pastaj hedhet në deponi.

Ky opsion aktualisht planifikohet të përdoret gjatë muajve të dimrit (4 muaj). Deponia më e afërt (Landovicë) është ofruar të pranon llumin me një çmim prej 5.60 Eur/t. Pasi që deponia është shumë afër impiantit, kostot e pritshme të transportit (do të kryhen nga kompani të jashtme) nuk janë më të larta se 4 Eur/t.

Vëllimet e pritshme vjetore të llumit janë 3,400t, prej të cilave vetëm ¼ do të hedhet tek deponia sipas konceptit të lartëcekur.

Kostot e pritshme për hedhjen (largimin) e llumit janë relativisht të vogla (21,000 Eur në vit.)

Përmbledhje

Tabela e mëposhtme përshkruan shumën totale që nevojitet për trajtimin e ujërave të zeza si dhe për trajtimin dhe largimin e llumit:

Pozita	2019 (10 muaj)	2020
Trajtimi i ujërave të zeza	235.556	310.706
Trajtimi i llumit & largimi	187.310	259.342
Totali	422.866	570.048

#### *4.6 Masat e planifikuara për arritjen e objektivave të Kompanisë*

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes financiare të Kompanisë janë planifikuar masa konkrete në përmirësimin e gjendjes aktuale:

- Përmirësimi i leximit të saktë të konsumit të ujit të pijes,
- Marrja e masave ndëshkuese ndaj mos leximit apo leximit qëllimisht të gabuar.
- Zvogëlimi i faturimit paushall.
- Vendosja e ujëmatësve tek konsumatorët pa ujëmatës apo ndërrimi i ujëmatësve jo funksional.
- Zvogëlimi i keqpërdorimeve
- Forcimi i ekipës së kontrollës
- Marrja e masave ligjore ndaj kyçjeve të paligjshme.
- Përmirësimi i inkasimit.
- Përmirësimi i raporteve Konsumatorë-Kompani
- Përgatitja dhe realizimi i fushatave të vetëdijesimit të popullatës duke bashkëpunuar edhe me institucionet tjera (Kuvendin Komunal, SHPK-ne, Gjykatat dhe Mediat).

#### *4.7 Planifikimi i bonuseve dhe Shpërblimeve*

Me qëllim të stimulimit dhe motivimit të stafit Kompania ka paraparë që në përfundim të secilit vit, varësisht nga performancat e arritura dhe bazuar edhe në rregulloren për shpërblime, të shpërblehen një numër i punëtorëve të dalluar.

#### 4.8 TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS – 2019-2021

Treguesit e Performancës	[Njesia]				
		2018	2019	2020	2021
Uje i faturuar-si perqindje	%	43.1%	46.38%	45.00%	46.26%
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	56.91%	53.62%	55.00%	53.74%
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	92.78	88.94	<b>88.85</b>	88.89
Norma e arketimit - Amviserite	%	91.90	<b>85.00</b>	<b>85.00</b>	<b>85.00</b>
Norma e arketimit -Komerical-Industrial	%	92.80	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>
Norma e arketimit -Institucional	%	99.16	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.14	1.19	1.18	1.24

#### ME IMPIANT

Treguesit e Performancës	[Njesia]	2018	2019	2020	2021
Te hyrat	€	4,151,283	4,713,469	4,894,620	5,143,292
Shpenzimet me IUZ	€	3,638,837	4,132,447	4,340,971	4,473,622
Mbulimi operativ	€	490,323	581,022	553,650	669,670
Keshi	€	-	-	-	-
Mbulimi operativ	%	1.14	1.14	1.13	1.15

#### 5 Plani i zhvillimit te stafit

Raportet midis stafit do të përcaktohen në bazë të Rregullores së organizimit të brendshëm të Ujësjetës, ndërsa kryerja e detyrave të punës do të bëhet në varshmëri të përshkrimit detal të secilit vend të punës veç e veç. Në bazë të këtij përshkrimi do të përcaktohen edhe kushtet minimale (përgatitja profesionale, përvoja e kaluar në punë të ngjashme apo të

përafërt, shkathtësitë tjera të veçanta për lidhjen e marrëdhënies së punës, shkalla e përgjegjësisë të punëtorëve, niveli i pagesës si dhe hierarkia e dhënies së përgjegjësisë).

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ndaj konsumatorëve, respektivisht mirëmbajtjes së rrjetit kompania ka paraparë që të rrisë numrin e punëtorëve për vitin 2019-2021 varësisht nga numri i fshatrave që do të merren në menaxhim. Këta punëtorë do të jenë të angazhuar kryesisht në shërbimin e inkasimit dhe kontrollës në zonat e reja të shërbimit

Stafi i punësuar do të jetë heterogjen:

- Nga aspekti i përgatitjes profesionale;
- Nga aspekti i shkathtësisë dhe racionalitetit në punë;
- Nga aspekti i përfaqësimit nacional;
- Nga aspekti i përfaqësimit gjinor;
- Nga aspekti i përfaqësimit fetar;
- Nga aspekti social etj.

## 5.1 NUMRI I PUNËTORËVE

### 5.4 Planifikimi i numrit të punëtorëve 2019-2021

Nr.	VITI	2018	2019	2020	2021
	<b>N.PUNESE</b>				
1	<b>PRIZREN</b>	235	241	243	244
2	<b>SUHAREKË</b>	37	38	39	40
3	<b>DRAGASH</b>	16	16	17	21
4	<b>MALISHEVË</b>	36	35	36	37
5	<b>HIDROREGJIONI</b>	324	330	335	342
6	<b>NFRYSHIMI</b>		6	5	7
7	<b>NDRSHI. - %</b>		1.9%	1.5%	2.1%

Rritja e planifikuar e numrit të personelit është bërë duke u bazuar në planifikimet dhe kërkesat me arsyeshmëri të Menaxherëve të Departamentëve dhe udhëheqësve të njësisë operative të Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit.

Arsyeshmëria e rritjes së numrit të punëtorëve në plan-biznes 2019-2021 është se parashihet një menaxhim dhe një mbikëqyrje e punimeve në nivel profesional në zona të reja të shërbimit.

Numri i punëtorëve në Plan-Biznes 2019-2021 është planifikuar duke u marrë parasysh: formimi ekipës së veçantë për mirëmbajtjen dhe analizën e sistemit ekzistues të kanalizimit-

Ujerave të zeza në qytetin e Prizrenit, zgjerimi i rritjes të ujësjellësit në zonat rurale sipas projektit të zyrës Zvicerane, rritja e numrit të konsumatorëve si dhe duke u bazuar në rritjen e aktiviteteve dhe efikasitetin të punës në Kompani.


Gjatë planifikimit të vendeve të punës dhe themelimit të marrëdhënies së punës do të respektohet Ligji i Punës., Ligji i Ndërmarrjeve Publike dhe Kodi i Etikës.

Kompania nuk bën asnjë dallim apo diskriminim në organizimin apo caktimin e obligimeve të punës në të gjitha shërbimet.


**SHPK- Personeli- Arsytet për angazhimin e stafit të ri .** Në strategjinë zhvillimore të kompanisë është edhe rritja e numrit të pikave për pagesa në qytet ( porto arka). Këtë vit është përcaktuar pjesa jugore e qytetit ( Lagjja "Bajram Curri") për hapjen e një porto arke. Kjo parashtrohet nevojën e punësimit të dy personave të cilët do të përkujdeset për pagesat e konsumatorëve. Trendi i rritjes së konsumatorëve në zonën e shërbimit imponon nevojën edhe për një faturist të cilin do të merret me vendosjen e gjendjeve të konsumatorëve , shkarkimin e pagesave dhe përgaditjen e faturave. Aktualisht kemi mbingarkim të numrit të konsumatorëve për faturistët aktual. Pasi jemi në prag të marrjes në menaxhim të fshatrave të reja , shumica e këtyre fshatrave kanë sistem të pompimit dhe duhet angazhuar një person edhe për mirëmbajtje të pompave edhe për lexim, inkasim të mjeteve nga konsumatorët e atij fshati. Varësisht nga numri i konsumatorëve në fshat, këta inkasant do të angazhohen edhe me gjysëm orari të punës.

### ORGANOGRAMI- PËR IMPANTIN E U.Z

Pershkrimi i vendit te punes	Nr. I punetoreve
Menaxheri i impiantit	1
Administrative	1
Tekniku i laboratorit	1
Asistent në laborator	1
Menaxheri i mirëmbajtjes dhe operativës	1
Teknik i elektro-mekanikës	2
Punëtorë i thjeshtë	5
Teknik i elektros	4
Punëtorë i thjeshtë	8
Sigurimi, Roja (24/7)	5
Menaxheri i impiantit	29



STRUKTURA ORGANIZATIVE  
 KRU „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A. PRIZREN



08 - INVESTIMET -  
JANAR-DHJETOR - 2019  
N.I.P. - PRIZREN

RANIT I PROJEKTTI	VIESHA	VIERA NE €	2019		
			INVESTITORI	QEVERIA	DONATOR
		496,200.00			19,469,200.49
1 Hartimi i projekteve kryesore per nevoja te komonise	PRIZREN	25,000.00	25,000.00		
2 Rehabilitimi i rrjetit ne rrugete Mera Terex	PRIZREN	186,000.00	15,000.00	200,000.00	150,000.00
3 Rehabilitimi i rrjetit te rruges ne lagjen Bajram Curri	PRIZREN	225,000.00	25,000.00	200,000.00	200,000.00
4 Rehabilitimi i rrjetit ne fsh. Zhir	PRIZREN	125,000.00	15,000.00	110,000.00	110,000.00
5 Rehabilitimi i rrjetit te ujepulluar ne lugin kurthilla	PRIZREN	95,000.00	45,000.00	50,000.00	50,000.00
6 Rehabilitimi i rrjetit ne fsh. Gjeputi	PRIZREN	346,000.00	140,000.00	347,342.80	206,000.00
7 Vendege e ugrimese te prodhimit ne nivel regional	PRIZREN	346,000.00	140,000.00		206,000.00
8 Furnimi me Uje te pijes per fshatrat e Rajonit te Hahit	PRIZREN	1,887,296.00	15,000.00	89,500.00	1,732,596.00
9 Rehabilitimi i zonave rurale	PRIZREN	1,500,000.00	20,000.00	75,000.00	1,480,000.00
10 Rehabilitimi i rrjetit ma Rrugete e SAVRANUT Prizren	PRIZREN	75,000.00		75,000.00	
11 Rehabilitimi i rrjetit me Rr. "Teq. GANISA", Prizren	PRIZREN	65,000.00		65,000.00	
12 Rehabilitimi i rrjetit me Rr. "Ersan Mazrekull", Prizren	PRIZREN	80,000.00		80,000.00	
13 Zevendesimi i qipit Bunari Z dert ne Rrethorac Kurthilla	PRIZREN	261,000.00	61,008.00	200,000.00	
14 Furnimi me Uje te pijes per fshatrat e Rajonit te Andriushe	PRIZREN	1,683,761.69			1,683,761.69
15 Rikonstruksion dhe zehimi i rrjetit shpordas ne beshkire dhe anelionin fqelur te varshive	PRIZREN	12,020,000.00	20,000.00		12,000,000.00
16 Identifikimi i rrjetit furnimes meq. fshat dert ne rrethoracat e fshatit	PRIZREN	886,000.00	5,000.00	100,000.00	100,000.00
17 Implementimi i sistemit per beasin dhe Eburim modal te kompanise	PRIZREN	130,000.00	20,000.00	100,000.00	650,000.00
18 Furnimi me ujete dhe ujmetare per konsumatorit shpirtak dhe industrial - 2000 cope	PRIZREN	120,000.00	20,000.00	100,000.00	
19 Rehabilitimi i rrjetit me Rr. "Beteqa e Panchikut", Prizren	PRIZREN	20,000.00	20,000.00		
20 Rehabilitimi i rrjetit me Rr. "Tani Shala", Prizren	PRIZREN	20,000.00	20,000.00		
21 Klerimi i objekteve te sistemit te Korfili me tek 40 burimet	PRIZREN	30,000.00	30,000.00		
<b>Totali</b>		<b>19,895,400.49</b>	<b>496,200.00</b>	<b>1,327,342.80</b>	<b>645,500.00</b>
			<b>90,700.00</b>		<b>7,244,000.00</b>
<b>RANIT I PROJEKTTI UJETA E ZEQA</b>					
1 Projekti i ujeveve te Zeqa per qytetin e Prizrenit Faza 1 dhe Faza 2	PRIZREN	5,000,000.00			500,000.00
2 Rehabilitimi i sistemit te kanalizimit kryesor ne qytetin e Prizrenit-KIV	PRIZREN	1,208,200.00	68700		114,000.00
3 Klerimi i kerkimit me ane e mape te rrjedhes se lumbeve dhe	PRIZREN	1,122,700.00	22600		116,000.00
<b>Totali</b>		<b>7,334,700.00</b>	<b>90,700.00</b>		<b>7,244,000.00</b>

INVESTIMET  
JANAR-DHJETOR - 2019  
N.I.P. SUHAREKË

RANIT I PROJEKTTI	VIESHA	VIERA NE €	2019		
			INVESTITORI	QEVERIA	DONATOR
		12,186.95			911,508.62
1 Vendege e qipit furnimes meq. kaptesha dert ne hyrje te shant. Sogel	SUHAREKË	40,168.73	9,686.95	30,481.84	€ 30,481.84
2 Rehabilitimi i rrjetit te ujepulluar ne fshatin Gerkoc para fshatit me njeqindim e kompanise	SUHAREKË	115,500.00	2,500.00		€ 113,000.00
3 Klerimi i uqepulluar te el. qipit fshatin Duhave	SUHAREKË	181,554.24			€ 181,554.24
4 Klerimi i uqepulluar te ri, per fshatin Bazar	SUHAREKË	223,815.20			€ 223,815.20
5 Klerimi i uqepulluar te ri, per fshatin Buloc	SUHAREKË	284,173.50			€ 284,173.50
6 Sinermet dhe rregullimet e uqepulluar	SUHAREKË	48,000.00			€ 48,000.00
7 Projekti NUT <b>Identifikimi / Digjes se Dregujtes</b> planifikohet te kaloj ne vitin 2020 pershke te sigurimit te donatorëve	SUHAREKË				€
<b>Totali</b>		<b>893,211.73</b>	<b>12,186.95</b>	<b>30,481.84</b>	<b>881,024.78</b>
<b>RANIT I PROJEKTTI UJETA E ZEQA</b>					
7 Mermetatimi dhe ngridimi i kanalizimeve	SUHAREKË	175,000.00		80,000.00	€ 175,000.00
<b>Totali</b>		<b>175,000.00</b>		<b>80,000.00</b>	<b>€ 175,000.00</b>

INVESTIMET  
JANAR-DHJETOR - 2019  
N.I.P. MALISHEVË

RANIT I PROJEKTTI	VIESHA	VIERA NE €	2019		
			INVESTITORI	QEVERIA	DONATOR
		41,500.00			48,500.00
3 Furnizim me pompa 55 kw ne S.P. Bange	MALISHEVË	45,000.00	22,500.00	22,500.00	
4 Furnizim me mjete pune (Estimator, vetura, kamioneta)	MALISHEVË	15,000.00	5,000.00	10,000.00	15,000.00
5 Rehabilitimi i qipit meqestral @ 315mm (Rrethorac Rajp der Malisheve) L= 5km	MALISHEVË	314,000.00	160,000.00	154,000.00	
6 Rehabilitimi i rrjetit te uqepulluar meq. rruge Ademi Jashari L=240	MALISHEVË	72,000.00	72,000.00		
<b>Totali</b>		<b>476,000.00</b>	<b>41,500.00</b>	<b>32,500.00</b>	<b>16,000.00</b>

INVESTIMET  
JANAR-DHJETOR - 2019  
N.I.P. DRAGASH

RANIT I PROJEKTTI	VIESHA	VIERA NE €	2019		
			INVESTITORI	QEVERIA	DONATOR
		3,600.00			24,000.00
1 Identifikimi i rrjetit furnimes me uje te pijes per komunen e Mamushites	MAMUSHË	250,000.00	50,000.00	200,000.00	
<b>Totali</b>		<b>250,000.00</b>	<b>50,000.00</b>	<b>200,000.00</b>	

INVESTIMET  
JANAR-DHJETOR - 2019  
N.I.P. MAMUSHË

RANIT I PROJEKTTI	VIESHA	VIERA NE €	2019		
			INVESTITORI	QEVERIA	DONATOR
		3,600.00			24,000.00
1 NUP - PRIZREN			486,300.00		
2 NUP - SUHAREKË			12,186.95		
3 NUP - MALISHEVË			41,500.00		
4 NUP - DRAGASH			3,600.00		
5 NUP - MAMUSHË			50,000.00		
<b>KRU, HIDROREGIONI JUGOR "SH. A - PRIZREN</b>			<b>603,486.95</b>		

NIP	INVESTIMET NGA MIRET VETANAKE	2019		
		KRU - HI	KOMUNAL	QEVERIA
1		50,000.00		
2			200,000.00	
3				200,000.00
4				
5				
<b>Totali</b>		<b>50,000.00</b>	<b>200,000.00</b>	<b>200,000.00</b>

NIP	INVESTIMET NGA GRANDET/ DONACIONET	2019		
		KRU - HI	KOMUNAL	QEVERIA
1		26,713,200.49		
2		1,086,506.62		
3		48,500.00		
4		24,000.00		
5		200,000.00		
<b>Totali</b>		<b>28,072,207.11</b>		

edhe perfunduar

me proces  
edhe situar si pasoj e defekteve te shpeshita gjat ketij viti  
edhe situar si pasoj e defekteve te shpeshita gjat ketij viti  
Edhe parazg nevojte pershika te modifikimit te sistemit te Korfili me tek 40 burimet